



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 26 tetor 2016

Fjalimi i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi

I nderuari President i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi,

I nderuari Kryetar i Kuvendit, zotëri Kadri Veseli,

I nderuari Kryeministër, zotëri Isa Mustafa,

I nderuari Zëvendëskryeministër, zotëri Hajredin Kuçi,

Të nderuar ministra Hoxha, Bajrami dhe Demolli,

Të nderuar kryetarë dhe gjyqtarë të Gjykatave Kushtetuese të Shqipërisë, të Maqedonisë, të Portugalisë, të Bullgarisë dhe të Turqisë,

Të nderuar ambasadorë,

Të nderuar kryetarë të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Shkëlqesitë tuaja,

Zonja e zotërinj,

Kam privilegjin dhe nderin që të hap ceremoninë e tetë të Vitit Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ju uroj mirëseardhje mysafirëve dhe miqve tanë nga vende të ndryshme të cilët sot janë të pranishëm dhe marrin pjesë në këtë ngjarje.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj për praninë e tyre udhëheqësit dhe përfaqësuesit e institucioneve tona kryesore shtetërore, si dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe diplomatikë, kolegët tanë nga gjyqësori - gjyqtarët dhe prokurorët, avokatët,

profesorët dhe gjithë të pranishmit. Me këtë dëshmohet respekti ndaj autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, të krijuar brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore që nga themelimi i saj.

Shumë prej jush do ta nderoni Gjykatën me praninë tuaj në Konferencën Ndërkombëtare nesër, e cila përqendrohet në temën “*Kontrolli incidental si mekanizëm kushtetues për sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve në vendet në tranzicion*”. Kjo është hera e parë që krentimi i vitit gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese do të përcillet nga një konferencë e tillë, ndërsa për rëndësinë e saj në forcimin e drejtësisë kushtetuese dhe në sundimin e ligjit në Kosovë do të flas pak më vonë.

Zonja dhe zotërinj,

Gjykata Kushtetuese po vazhdon të forcojë sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, duke krijuar jurisprudencë të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në interpretimin e dispozitave të Kushtetutës.

Edhe gjatë vitit të fundit gjyqësor, Gjykata vendosi raste të rëndësishme për shtetin dhe për shoqërinë, e të cilat do t’i paraqes shkurtimisht pas pak.

Po ndodh dhe ne po e vërejmë që vendimet tona analizohen, interpretohen por dhe keqinterpretohen nga grupe të ndryshme apo nga individë. Vendimet shikohen në detaje dhe komentohen paragraf për paragraf, e shpesh jashtë kontekstit apo që t’i shërbejnë disa qëllimeve antikushtetuese, madje edhe kundër vlerave të Kushtetutës dhe shtetësisë së Republikës.

Dëshiroj të theksoj se gjatë këtij viti asnjë nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk është rezultat i presionit shoqëror ose politik apo ndonjë komoditeti. Vendimet tona janë rezultat i një analize të përkushtuar të rastit dhe zbatimit rigoroz të dispozitave kushtetuese, në përputhje me standardet më të larta vendore dhe ndërkombëtare. Misioni i Gjykatës nuk është që të marrë vendime që mund të jenë të kënaqshme vetëm për grupe apo për individë të veçantë. Misioni i Gjykatës është që të shërbejë si interpretues përfundimtar i Kushtetutës, duke mbrojtur themelet kushtetuese të

Perandori Justinian nr. 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o

Tel: +381 (0)38 60 61 62; Fax: +381 (0)38 60 61 70; www.gjk-ks.org

shtetit tonë dhe të drejtat e liritë e çdo personi fizik ose juridik në Republikën e Kosovës. Ne duhet ta mbrojmë dhe ta interpretojmë atë, ashtu siç kërkohet dhe jo në mënyrën se si dikush dëshiron.

Viti i kaluar ishte sfidues për Gjykatën edhe për ruajtjen e pavarësisë së saj fizike dhe u desh që të argumentojmë dhe të bindim autoritetet përkatëse se nuk është Gjykata Kushtetuese pjesë e gjyqësorit dhe se është institucion i pavarur, prandaj kishte nevojë për selinë e saj të ndarë dhe veçmas. Me një qëndrim të unifikuar, këmbëngulës dhe me argumente të arsyetuara mirë si dhe rrjedhimisht mbështetjes së fituar, Gjykata arriti që të mbajë vendndodhjen e saj aktuale. Ruajtja dhe mbrojtja e pavarësisë fizike dhe funksionale të Gjykatës nuk është një zgjedhje, ose një luks. Është domosdoshmëri.

Zonja dhe zotërinj,

Vitin e kaluar në ceremoninë e vitit gjyqësor pata bërë thirrje te Kuvendi që të plotësojë pa vonesë vendet e lira për dy gjyqtarë kushtetues. Fatmirësisht, procesi përfundoi me sukses dhe Gjykatës sonë iu bashkuan dy gjyqtare të reja: znj. Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe znj. Gresa Caka-Nimani, ku gati pas tre vjetësh, Gjykata Kushtetuese më në fund u kompletua plotësisht.

Iu dëshiroj mirëseardhje të ngrohtë të dyja gjyqtareve të reja dhe iu uroj sukses në punën e tyre. Të shërbesh si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të vendit tënd është ndër nderet dhe privilegjet më të mëdha dhe pozita më e lartë për një jurist.

Dua të theksoj që është krenari dhe kënaqësi për mua të përfaqësoj një institucion i cili përfshin një numër të madh të vendimmarrësve gra.

Gjithashtu, falënderoj për kontributin e tij në zhvillimin e drejtësisë kushtetuese në Kosovë gjyqtarin Robert Carolan, i cili pas 7 vjetësh u largua nga Gjykata jonë. Gjyqtari Bob do të zëvendësohet nga një gjyqtar vendor dhe unë do të doja t'u bëj thirrje institucioneve përkatëse që ta plotësojnë këtë pozitë, pa vonesa, për t'i mundësuar Gjykatës funksionimin dhe punën në kapacitetin e saj të plotë.

Zonja dhe zotërinj,

Tani, shkurtimisht do të prezantoj punën e Gjykatës gjatë vitit të kaluar gjyqësor. Gjithsej kemi pranuar 118 kërkesa, shumica e të cilave (103) janë paraqitur nga parashtrues individualë, ndërsa 15 kërkesa janë paraqitur nga institucione shtetërore.

Që nga themelimi i saj në vitin 2009, Gjykata ka pranuar gjithsej 1.216 kërkesa, nga të cilat 1.127 janë vendosur, që është më shumë se 90% e rasteve tona.

Do të përmend dy raste që janë vendosur vitin e kaluar. I pari është rasti në lidhje me formimin e Asociacionit të Komunave Serbe, vendosur me Aktgjykimin KO130/15.

Në rastin e Asociacionit të Komunave Serbe, faktet janë si në vijim: më 19 prill 2013, Kryeministrat e Republikës së Kosovës dhe të Serbisë nënshkruan “*Marrëveshjen e Parë të Parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*”. Më 27 qershor 2013, Kuvendi votoi dhe miratoi Ligjin me të cilin u ratifikua kjo marrëveshje ndërkombëtare. Ndër të tjera, ai parashihte edhe krijimin e një Asociacioni/Bashkësie të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Më pas, ishte dakorduar dokumenti i titulluar “*Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore*”. Parimet e elaboruara në këtë dokument do të shërbenin si udhërrëfyes për themelimin e Asociacionit. Duke qenë se ish Presidentja e Kosovës konsideronte se ky dokument shtonte elemente të reja në procesin e krijimit të Asociacionit, ajo iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së këtyre Parimeve, veçanërisht në qoftë se ato ishin në përputhje me shkronjën dhe frymën e Kushtetutës, neni 3 [Barazia para Ligjit], Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], si dhe Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës.

Gjykatës i ishte kërkuar të shqyrtojë pyetjet e Presidentes së Kosovës, si pyetje kushtetuese që kanë implikime për funksionimin demokratik të shtetit të Kosovës dhe, si të tilla, janë të një rëndësie të madhe për rendin kushtetues të Kosovës.

Në arsyetimin e saj, Gjykata shqyrtoi çdo pjesë të Parimeve, kapitull për kapitull, dhe arriti në përfundimin se:

- Formimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë tashmë është bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik me rastin e ratifikimit të Marrëveshjes së Parë, e cila parashihte formimin e tij;
- Megjithatë, Gjykata konstatoi se këto parime nuk ishin tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës dhe me nenet e saj të përmendura në mënyrë specifike në vendim;
- Gjykata gjithashtu konstatoi se elaborimi i Parimeve në një akt juridik dhe Statut të Asociacionit duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe me standardet kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe do të bëhen siç arsyetohet me Aktgjykimin e Gjykatës;
- Gjykata konstatoi se akti juridik mbi Parimet dhe Statuti i Shoqatës, duke përfshirë edhe amendamentet e saj, duhet të shqyrtohen nga Gjykata, kur ato janë të gatshme, gjegjësisht të sqarohet qartë se rezultati i mëtejshëm nga hartimi ligjor duhet të rishikohet për kushtetutshmërinë e saj para se të hyjnë në fuqi.

Rasti i dytë i një rëndësie të madhe kushtetuese ishte ai i Manastirit të Deçanit, Aktgjykimi KI132/15. Ky rast është parashtruar nga Manastiri i Deçanit, në cilësinë e personit juridik.

Gjykata kishte për detyrë të vlerësonte kushtetutshmërinë e dy vendimeve të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (*në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave*).

Manastiri i Deçanit konsideronte se nëpërmjet këtyre dy vendimeve i janë shkelur e drejta për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shfrytëzim të mjeteve juridike dhe për mbrojtje të pronës.

Gjykata shqyrtoi nëse Kolegji i Ankesave kishte juridiksion për të dëgjuar ankesat e palëve kundërshtare: Agjencisë Kosovare për Privatizim dhe dy ndërmarrjeve shoqërore, si dhe a kishte juridiksion për të marrë vendimet e kontestuara duke pasur parasysh që i njëjti Kolegj i Ankesave në vitin 2010 kishte përcaktuar paraprakisht se këto palë kundërshtare nuk ishin palë të autorizuara në këtë rast.

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë rast, Gjykata shpalli të pavlefshme dy vendimet e kontestuara të Kolegjit të Ankesave, ndërsa konstatoi se dy vendimet e vitit 2012 të Kolegjit të Specializuar për Pronësinë, janë përfundimtare dhe të detyrueshme e, si të tilla, janë *res judicata*.

Gjykata sqaroi se, përkundër procedurave të shumta dhe komplekse të cilat u mbajtën para vendimeve të kontestuara, ishin jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, Gjykata përkujtoi se palët kundërshtare në këtë rast kanë pasur mundësinë të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që t'i shqyrtojë kërkesat e tyre dhe ato nuk e bënë këtë asnjëherë.

Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, i cili presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, që sigurohet, ndër të tjera nëpërmjet *res judicata*.

Zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj t'ju rikujtoj se përkundër faktit që Gjykata Kushtetuese përmendet kryesisht për rastet mediatike, pjesën më të rëndësishme të punës e bën në nxjerrjen e vendimeve ku parashtruesit individualë të të gjitha komuniteteve në Kosovë, pretendojnë se nga autoritetet publike u janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e njeriut.

Si shembull, vitin që po lëmë pas, në një rast parashtruesi individual kishte pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e një aksidenti automobilistik dhe në procedura të rregullta gjyqësore u vendos që ai duhej të kompensohej dhe i dhanë si shpërblim një shumë të caktuar parash. Në procedurën për revizion pranë Gjykatës Supreme, u ndryshuan vendimet e gjykatave të instancave më të ulëta lidhur me shumën e kompensimit. Gjykata Kushtetuese nuk ishte e shqetësuar për zvogëlimin e kompensimit si të tillë, por për mungesën e arsytimit të dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme për ndryshimet e vendimeve të gjykatave të rregullta. Kështu, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për vendim të arsyetuar.

Dëshiroj të përmend edhe një rast me rëndësi, ku parashtrues janë katër pjesëtarë të komunitetit joshumicë serb, të cilët kontestonin mosekzekutimin e pesë vendimeve të plotfuqishme të autoriteteve përkatëse të Republikës së Kosovës, të viteve 2012 dhe 2013, të cilat konfirmonin të drejtën e tyre në pronë.

Gjykata gjeti se mosekzekutimi i këtyre vendimeve përfundimtare përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së pasi vendimet në fjalë ishin bërë *res judicata* dhe parashtruesit e kërkesës ishin privuar padrejtësisht nga pasuria e tyre.

Rrjedhimisht, Gjykata urdhëroi autoritetet relevante që t'i përmbaronin vendimet dhe ta informonin Gjykatën lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të saj.

Rastet e tilla tregojnë se sa e rëndësishme është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të gjithë individëve të Republikës së Kosovës dhe Gjykata jonë është e përkushtuar të mbrojë vlerat kushtetuese të Republikës sonë dhe standardet më të larta ndërkombëtare duke kontribuar në forcimin e shtetit.

Zonja dhe zotërinj,

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë produkt i një pune kolektive dhe kolegjiale të gjyqtarëve dhe të këshilltarëve ligjorë. Vendimet e Gjykatës së Strasburgut dhe standardet e saj përbëjnë detyrim kushtetues për Gjykatën tonë dhe janë burimi ynë kryesor i frymëzimit dhe i njohurive praktike. Detyrimi ynë kushtetues për të zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut është vënë në dukje në çdo rast që kemi shqyrtuar. Ne i inkurajojmë institucionet e tjera të Kosovës, dhe sidomos gjykatat e rregullta, që në punën e tyre t'i referohen jurisprudencës së Gjykatës Evropiane dhe standardeve të saj, atëherë kur duhet të garantohen të drejtat dhe liritë.

Si përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin e përfitimeve që ka përdorimi më efikas i kësaj dispozite kushtetuese nga ana e gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës, sikurse përmenda më herët, për herë të parë, nesër do të mbahet një konferencë ndërkombëtare me titull “*Kontrolli incidental si mekanizëm kushtetues në sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve në vendet në tranzicion*”. Qëllimi i kësaj konference është që të rritet ndërgjegjësimi për ta bërë këtë mekanizëm një vegël të rëndësishme për sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve në Republikën e Kosovës. Deri më tani, Gjykata jonë ka pranuar vetëm dy kërkesa të tilla.

Republika e Kosovës ka trashëguar nga e shkuara e saj një infrastrukturë juridike komplekse dhe të ndërlikuar. Kur i shtojmë kësaj edhe legjislacionin e miratuar nga administrata ndërkombëtare dhe legjislacionin e ri pas pavarësisë së Kosovës, ekziston një potencial i madh dhe mundësi reale për “konflikte ligjesh” dhe për “antikushtetutshmëri të ligjeve”.

Së fundmi, në shoqëri dhe në radhët e profesionistëve, ka nisur një debat serioz që lidhet me kushtetutshmërinë e Ligjit për kundërvajtjet. Debatet janë të dobishme, mirëpo roli i atyre që e zbatojnë ligjin, është vendimtar dhe drejtësia kushtetuese duhet ta thotë fjalën e saj.

Prandaj, kur ka dyshime lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji kur ai aplikohet, është në dorën e gjykatave të rregullta apo të palëve në procedurë që të kërkojnë kontrollin incidental, d.m.th. të kërkojnë vlerësimin dhe shqyrtimin e ligjit për pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën. Për më tepër, ky është i vetmi mekanizëm për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve pa asnjë afat kohor.

Përfitoj nga rasti t'i drejtohem gjykatave të rregullta, avokatëve dhe palëve në procedura, në rastet kur ato kanë dyshime lidhur me kushtetutshmërinë e ndonjë ligji apo ndonjë dispozite të tij, që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për kontroll incidental.

Të nderuar të ftuar,

Gjykata Kushtetuese ka arritur të ketë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin ndërkombëtar. Gjykata është bërë anëtare e konsoliduar e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese. Ne kemi krijuar një bashkëpunim të frytshëm dhe të dobishëm edhe me Komisionin e Venecias, ku si anëtare dhe kontribuuese aktive në këtë forum të rëndësishëm kushtetues, jemi duke përfitur nga përvojat shumëvjeçare të gjykatave anëtare dhe gjithashtu kemi përdorur këtë forum për të kërkuar analiza krahasuese në lidhje me rastet tona.

Aktualisht, Gjykata vazhdon përpjekjet e saj, e ndihmuar nga shumë gjykata të tjera kushtetuese, për anëtarësim në Shoqatën Evropiane të Gjykatave Kushtetuese dhe në Rrethin e Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese Evropiane. Ne shpresojmë se do ta arrijmë këtë qëllim në të ardhmen e afërt.

Dëshiroj sonte t'i shpreh mirënjohje organizatave të ndryshme për kontributin që kanë dhënë në ndërtimin institucional dhe fuqizimin e Gjykatës nëpërmjet

organizimit të seminareve, të punëtorive, të trajnimeve dhe vizitave në gjykata të tjera kushtetuese dhe në institucione ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet mundësimin të pjesëmarrjes sonë në konferenca të ndryshme në Kosovë dhe jashtë vendit. Ne u jemi jashtëzakonisht mirënjohës për këtë përkrahje.

Në fund, dëshiroj të falënderoj bashkëpunëtorët e mi më të afërt, pa të cilët suksesi i Gjykatës nuk do të kishte qenë i mundur. I shpreh falënderime për angazhimin e tyre në Gjykatë dhe për punën e tyre të palodhur dhe profesionale Zëvendëskryetarit dhe të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës – vendas dhe ndërkombëtarë. Gjithashtu dëshiroj të falënderoj edhe këshilltarët tanë ligjorë – vendas dhe ndërkombëtarë – për kontributet e tyre të vlefshme, si dhe Kabinetin tim dhe të gjithë Sekretariatit për angazhimin dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm në mbështetje të cilësisë dhe të efikasitetit të punës së Gjykatës sonë.

Ju falënderoj për vëmendjen!